

VENDIM
Nr. 182, datë 20.3.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE TË SIGURISË DHE ÇMIMIT TË
PULLAVE FISKALE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 342, datë 13.5.2026)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 40, pika 1, e 42, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e elementeve kryesore të pullave fiskale me sistem gjurmimi, si më poshtë vijon:

A) Karakteristikat e sigurisë

Elementet e sigurisë së pullave fiskale kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Karakteristika të dukshme me sy të lirë:

i. sfond i sigurt që përfshin elemente grafike të tipit guilloche dhe tekst të imët;

ii. kod dydimensional i dukshëm (DataMatrix) dhe kod i lexueshëm nga njeriu (Human Readable Code – HRC);

iii. element optik me ndryshim ngjyre (optically variable colour-shifting element);

iv. strukturë rezistente ndaj ndërhyrjeve, me prerje teknike (die-cuts) në shtresën vetëngjitëse;

b) Karakteristika gjysmë të fshehura (Semi-Covert Features):

i. elemente grafike të integruara me efekte të dyfishta polarizimi;

ii. karakteristika reaktive ndaj rrezeve ultraviolet (UV), të dallueshme përmes ekspozimit ndaj dritës ultraviolet UV;

iii. elemente sigurie grafike të integruara brenda kodit 2D, të verifikueshme përmes aplikacionit zyrtar;

c) Karakteristika të fshehura (të padukshme me sy të lirë):

i. kod dydimensional i padukshëm, i zbulueshëm vetëm me pajisje të specializuara;

ii. identifikues unikë të enkriptuar, të koduar si në kodet e dukshme ashtu edhe në ato të padukshme, të menaxhuar përmes Sistemit të Gjurmueshmërisë dhe Kontrollit të ALBTrace;

iii. substrat që përmban fibra sigurie, të integruara në materialin bazë;

ç) Analiza të detajuara hetimore:

Elemente sigurie të nivelit të avancuar, të integruara në materialin e pullës fiskale, të cilat nuk janë të dukshme dhe nuk mund të verifikohen me mjete standarde kontrolli.

Këto karakteristika mundësojnë autentifikimin shkencor të pullës fiskale vetëm përmes analizave të specializuara të kryera në laboratorë të analizave të detajuara, duke përdorur pajisje dhe metoda teknike të dedikuara.

B) Shënjimi i drejtpërdrejtë i sigurt për birrën vendase dhe produktet e tjera të pijeve alkoolike që prodhohen në Shqipëri nga prodhues në shkallë të madhe ose të importuara nga importues të autorizuar për këtë qëllim:

a) Një kod unik dydimensional (Datamatrix) printohet drejtpërdrejt mbi produkt gjatë procesit të kodimit;

b) Kodi gjenerohet dhe menaxhohet përmes Sistemit të Gjurmueshmërisë dhe Kontrollit të ALBTrace;

c) Shënjimi projektohet në mënyrë të tillë që të jetë rezistent ndaj ndërhyrjeve dhe manipulimeve, si dhe të mundësojë verifikimin nga autoritetet kompetente;

ç) Shënjimi përmban elemente sigurie të menaxhuara elektronikisht, të barasvlershme në nivel sigurie me ato të pullave fiskale fizike.

2. Çmimi i pullave fiskale është, si më poshtë vijon:

Produkti	Lloji i pullës fiskale	Çmimi për mijë copë në euro, (pa përfshirë taksat e tjera dhe TVSH-në)
Duhan	Pulla e akcizës	15.65 euro
Verë	Pulla e akcizës	25.04 euro
Birra	Kodi i sigurisë/pulla e akcizës	17.22 euro
Alkool	Kodi i sigurisë/pulla e akcizës	25.05 euro

2/1. Zbatimi i sistemit të pullave fiskale, si version i përditësuar i sistemit ekzistues nëpërmjet shtimit të funksionaliteteve të reja dhe rritjes së nivelit të sigurisë, sipas parashikimeve të këtij vendimi, fillon në datën 1 korrik 2026.

Pullat fiskale të prodhuara dhe të vendosura në përdorim përpara datës 1 korrik 2026 mbeten të vlefshme dhe të përdorshme deri në përdorimin e plotë të tyre, por jo më vonë se data 1 korrik 2027.

Gjatë periudhës kalimtare drejt sistemit të ri të pullave fiskale, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria aksionare shtetërore “ALBTrace Co” sh.a. të marrin masat organizative, teknike dhe administrative.

3. Ngarkohen Ministria e Financave shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria aksionare shtetërore “Albtrace Co.” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku